



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të nenit 17 shkronja b të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 15 të Ligjit për Planifikimin Hapsinor, nr. 2003/14 dhe nenit 19 shkronja b të Statutit të Komunës nr. 01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 maj 2012, miratoi këtë:

V E N D I M **PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN “ZONA QENDËR” NË** **PODUEVË**

Neni 1

1.1 Miratohet Planit Rregullues Urban “Zona Qendër” në Podujevë, në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Podujevës.

Neni 2

2.1 Pjesa e gjithmbarshme e sipërfaqes tokësore e përpunuar urbanistike përfshin territorin prej 31.00 ha dhe përkufizohet me rrugët: “Skënderbeu”, “Afrim Zhitia”, “Ilir Konushefci”, hekurudha Podujevë – Prishtinë, rrugët “Bedri Bajrami”, “Zahir Pajaziti”, objekti e ish Ndërmarrjes “8 Nëntori” dhe lumit Llap deri te Ura mbi lum (te lagja e Fushalive) si dhe parashihet:

- Ndërtimi ekzistues dhe gjendja e tyre,
- Ndërtimi banesor individual dhe shumë banesor me politikat e banimit,
- Infrastruktura fizike sipërfaqësore me gjendjen ekzistuese të rrugëve me trotuare dhe zhvillimi i ardhshëm i rrjetit brenda lokacionit dhe lidhja e saj me zonat fqinje,
- Infrastruktura fizike nëntokësore,
- Infrastruktura sociale.

Neni 3

3.1 Me Planin Rregullues Urban në sipërfaqen e përpunuar parashihet ndërtimi i objekteve:

Banimi individual me etazh (B+P+2) me përshkrim të kushteve të ndërtimit,

Banim shumë banesor i ultë me etazh (B+P+3 deri 4K) me përshkrim të kushteve të ndërtimit,

Banimit shumë banesor i mesëm me etazh (B+P+5 deri 7k) me përshkrim të kushteve të ndërtimit.

Neni 4

4.1 Pjesë përbërëse e këtij vendimi është Elaborati i Planit Rregullues Urban. Elaborati i Planit Rregullues Urban përbëhet prej pjesës tekstuale dhe pjesës grafike. Pjesa tekstuale përmban:

Arsyetimin e Planit Rregullues Urban,

Pjesa grafike përmban:

- Ortofotot, incizimin e gjendjes faktike ekzistuese dhe të re.
- Hartat – vizatimet në përpjesë 1:2500,
- Rregullat e ndërtimit dhe rregullimit,
- Planin e infrastrukturës rrugore dhe profilet,
- Vijat ndërtimore, vijat rregulluese,

Neni 5

5.1 Zbatimin e vendimit e bënë Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit.

Neni 6

6.1 Vendimi hyn në fuqi pas miratimit, përkatësisht 8 ditë pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal.

Nr. 01/110-350
Podujevë,
28 maj 2012

Kryesuesi i Kuvendit
Hazir Raçi